



“ALL-LLAHUMME
MË BËJ TA MADHËROJ
FALËNDERIMIN NDAJ TEJE!..”



“ZIDNI”
NJË LUTJE PËR MUA,
PËR TY, PËR TË GJITHË...



REFLEKSIONE
NE 20 VJETORIN
E XHAMISË “EBU BEKËR”

Viti XIII - Nr. 11 (153),
Nëntor, 2015

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

E XHUMAJA E NJË DITE, SA 25 VITE DËSHMI...





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, Zotit të vetëm të botëve, i Cili na mësoi se falënderimi është tregues i përkujdesjes ndaj mirësive hyjnore, garant i vazhdimësisë së tyre në jetë, shenjë e falënderimit të zemrës ndaj dhuntive, me të cilat është rrethuar jeta e jonë.

Thotë në Kur'anin Famëlartë: [Dhe (përkujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm se: “Nëse falënderoni, do t’ua shtoj të mirat, e nëse përbuzni, s’ka dyshim, dënimi Im është i vështirë!”]¹

Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës tonë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), që u dërgua mëshirë dhe udhëzim për krejt krijesat e Zotit. Prej udhëzimit dhe porosive të tij, ishte edhe lutja për t’u bërë falënderues e mirënjohës ndaj Zotit! Ibn Abbasi (r.a) tregon se Resulull-llahu (a.s) lutej: “All-llahumme më bëj falënderues ndaj Teje...”²

TË DASHUR BESIMTARË,

Me mbarësinë e All-llahut, pas dy ditësh hyjmë në muajin nëntor, të vitit diellor 2015.

Në pamje të parë, ky konstatim nuk tregon asgjë. Por, në të vërtetë, për qytetarët e Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë, nëntori i këtij viti vjen si një muaj i rëndësishëm që na kujton mirësinë e madhe të All-llahut, kur para 25 viteve më

“ALL-LLAHUMME MË BËJ TA MADHËROJ FALËNDERIMIN NDAJ TEJE!..”

parë, u rihapën objektet fetare në këtë qytet, duke u shënuar largimi i resë së zezë mbi 23 vjeçare, nga rrezet e para të shpresës, dritës dhe ripërtëritjes së vlerave universale të besimit dhe fesë tek ne!

Kur e kthen kokën pas dhe mendon, hera-herës të duket e pabesueshme!

A thua vërtetë ka ndodhur që në këtë vend, është mohuar Zoti dhunshëm e zyrtarisht?!

A thua vërtetë ka ndodhur që në këtë vend besimtarësh, dijetarësh, njerëzish të mirë e me kulturë të gjerë, janë prishur Shtëpitë e Zotit, janë shkallmuar e rrënuar pa mëshirë?!

A thua vërtetë ka ndodhur që në këtë vend, ku thirrja e shpëtimit ka shoqëruar pesë herë në ditë muslimanët, si dëshmi besnikërie e dashnie ndaj Zotit të gjithësisë, është ndalur thirrja e zemrës e fjalët e ezanit, për më shumë se 23 vjet?!

A thua vërtetë ka ndodhur që në këtë vend, janë përndjekur agjëruesit e Ramazanit, është ndaluar haxhi i Shtëpisë së Lashtë, është ndaluar dhikri e salavati, urimet për bajram e betimet për emër të All-llahut?!

A thua vërtetë ka ndodhur që në këtë vend, janë djegur librat e dijes, janë dhunuar shtëpitë e hoxhallarëve, janë zhveshur nga misioni i tyre, janë burgosur, poshtëruar e nënçmuar publikisht?

(Kjo më kujton dëshminë e mikut tim, Ahmet Osja, ish-drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, që më tregonte se kur përfaqësuesit e pushtetit kishin shkuar të bastisnin shtëpinë e të atit, të nderuarit Osman Meti, për t’i marrë librat e bibliotekës së tij, me të cilët kishin ngarkuar karrocat, e kishin goditur aq shumë sa e kishin rrëzuar përtokë, teksa përpiquej të ndalonte krimin e tyre ndaj pasurisë së tij...

Më kujton edhe kujtimet e njërit prej djemve të Hafiz Ali Krajës, që më

*BIBLIOTEKA E BABËS
KA QENË E MADHE.
NJË RAFT I MADH
ME XHAMA SA KREJT
FASADA E MURIT, NË NJË
DHOMË, QË I KEMI THËNË
“ODA E QITABEVE”... PASI
IA MORËN LIBRAT, AI
KISHTE VETËM
NJË NGUSHËLLIM,
THOShte: “DIKUSH DO T’I
LEXOJË ATA LIBRA E DO TË
MA ÇOJË NJË RAHMET...”*

thoshte se: [... kanë ardhur edhe nga kartoteka e historisë së Shqipërisë për të marrë libra nga biblioteka e babës tim. Libra të Hafizit ka marrë edhe prof. (nuk dua ta shënoj emrin këtu), që i ka patur në bibliotekën e tij personale... Biblioteka e babës ka qenë e madhe. Një raft i madh me xhama sa krejt fasada e murit, në një dhomë, që i kemi thënë “oda e qitabeve”... Pasi ia morën librat, ai kishte vetëm një ngushëllim, thoshte: “Dikush do t’i lexojë ata libra e do të ma çojë një rahmet...”]³

A thua vërtetë ka ndodhur që muslimanët e kësaj toke kanë mohuar Zotin haptas, duke bërë propagandën marksiste dhe duke thirrur drejt materializmit dhe ateizmit, pa ndrojtje e me shumë zell?!

A thua vërtetë ka ndodhur që në këtë tokë e ndër bijtë e saj është personifikuar ajeti kur’anor, ku All-

3. Nga biseda e zhvilluar me z. Mehdi Ali Kraja në Shkodër, më 14. 03. 2007. (Material në dorëshkrim).

1. Kur’ani, Ibrahim: 7.

2. Transmetuar nga Ebu Davudi.

llahu i Madhëruar urdhëron: “Kush është më zullumqar se ai që është këshilluar me argumentet e Zotit të vet, e ua kthen shpinën atyre dhe harron atë që vetë e punoi?”⁴

A thua vërtetë ka ndodhur që në këtë vend, njerëzit kanë mohuar Kur'anin, ashtu sikurse shkruan Hafiz Ali Korça, se: “Komunizmi nuk pajtohet me asnjë fe sepse bazohet mbi pafesinë, se thotë: Zot s'ka. Profet s'ka (hasha). Zoti s'është gjë fare. S'është as një as disa. S'ka Zot që të ketë edhe profetë. Profetët janë disa njerës gënjeshtarë që librat i kanë përdorur si vegla për të rjepur botën edhe të ushqeheshin mbi kurrizin e tyre. Ata thonë se Tevratit, Inxhilit dhe Kur'anit i ka kaluar koha.

Thonë një kohë bota vepronte sipas Kur'anit e sipas Inxhilit dhe Tevratit edhe me këtë mënyrë siguronin jetesën, por sot çdo njeri duhet të jetojë me Kur'anin e Karl Marksit! PLASJA T'U BJERË!...”⁵

A thua vërtetë ka ndodhur që në këtë tokë e ndër bijtë e saj është personifikuar ajeti kur'anor, ku All-llahu i Madhëruar urdhëron: “E kush mund të jetë më mizor se ai, që në xhamitë e All-llahut pengon të përmendet emri i Tij (të bëhet ibadet) dhe përpiket për shkatërrimin e tyre.”⁶

A thua vërtetë ka ndodhur..?!

TË DASHURIT E MI,

Sot, është koha që në këtë përvjetor të 25-të të rihapjes së xhamisë së parë në Shkodër e Shqipëri, Xhamisë së Plumbit, më 16 nëntor 1990, të gjithë ne, si brez besimtar, të lidhur me Fjalën e All-llahut, me traditat e udhëzimet e të Dashurit të Tij, Hz. Muhammedit (a.s), me Kur'anin Famëlartë; leximin, studimin dhe zbatimin e tij në jetë etj, të jemi falënderues dhe mirënjohës ndaj Zotit për këtë mirësi të madhe të lirisë së besimit!

Sot, më shumë se asnjëherë

4. Kur'ani, El-Kehf: 57.

5. Hafiz Ali Korça, “Bolshevizmi është shkatërrim i njerëzimit”, botim i tretë i përshtatur dhe i përgatitur për shtyp nga prof. dr. Feti Mehdiu, Prishtinë, 2001, fq. 21-22. (Botimi i parë, Tiranë, 1925. Botimi i dytë, Michigan, 1993).

6. Kur'ani, El-Bekare: 114.

tjetër, e kemi për detyrë morale e shpirtërore, ta dëshmojmë besimin e fenë tonë, ta shprehim mirënjohjen dhe falënderimin tonë ndaj All-llahut të Madhëruar, për momentin kur vëmë kokën në sexhde, pa frikë e ndrojtje!

Për mirësinë e madhe të faljes së namazeve në 57 xhamitë që ka sot Shkodra, ku të duam e kur të duam, në cilindo prej pesë vakteve ditore!

Për mirësinë e madhe të dëshmimit të madhështisë së agjërit të Ramazanit dhe mbushjes së xhamive me të rinj, që vijnë për të falur teravinë e namazet me xhemat!

Për mirësinë e madhe të medresesë sonë, ku fëmijët tanë kanë mundësinë të marrin sadopak edukatën fillestare islame, për t'u rritur me sadopak imunitet besimi, që do të vlejë në përballjen e tyre me sprovat e reja të femohimit, ateizmit, shthurrjes morale, diabolizmave pafund, me të cilat po rrethohet sërish shoqëria e jonë!

TË DASHURIT E MI,

Gjatë ditëve në vijim, ju jeni të ftuar të bëheni pjesë e aktiviteteve të larmishme, të cilat Myftinia Shkodër ka planifikuar të zhvillojë, sipas një programi të larmishëm, që do ta merrni në dalje nga xhamia.

Ju ftoj me zemër të bëheni pjesë e këtyre aktiviteteve, sa të keni mundësi, për të jetuar e dëshmuar këtë mirësi të madhe të besimit e të fesë tonë të shtrenjtë islame.

Sepse, pasha All-llahun, për këto mirësi me të cilat jemi mbuluar gjatë këtyre 25 viteve në besim, ne e meritojmë të themi me të madhe, sikurse Ebu Hurejra (r.a) që thoshte: “Kam mësuar një lutje nga Resulull-llahu (a.s), nuk do ta lë asnjëherë: All-llahumme më bëj ta madhëroj falënderimin ndaj Teje!...”⁷

Ju ftoj me zemër, të përhapni kudo lajmin e mirë të mirësisë së madhe të lirisë së besimit, të cilën duhet ta ruajmë e ta mbrojmë me përkushtimin tonë, me sakrificat tona, me mëkimin e tij fëmijëve tanë, me angazhimin për të mos lejuar që asnjë prekje jashtë fesë e besimit tone, të depërtojë në familjet tona,

7. Transmetuar nga Tirmidhiu.

*Ju ftoj me zemër,
të përhapni kudo lajmin
e mirë të mirësisë së madhe
të lirisë së besimit,
të cilën duhet ta ruajmë
e ta mbrojmë me
përkushtimin tonë,
me sakrificat tona,
me mëkimin e tij
fëmijëve tanë,
me angazhimin për të mos
lejuar që asnjë prekje jashtë
fesë e besimit tone,
të depërtojë në familjet tona,
në bisedat tona,
në kulturën tonë, në shpirtin
e kësaj shoqërie e kësaj toke
të lidhur me emrin “All-llah”
dhe fenë e Tij!*

në bisedat tona, në kulturën tonë, në shpirtin e kësaj shoqërie e kësaj toke të lidhur me emrin “ALL-LLAH” dhe fenë e Tij!

Ju ftoj me zemër të bëhemi përkrahësit dhe mbrojtësit e vlerave të Islamit e dritës së tij, përhapësit e Fjalës së Zotit dhe mësimave të Hz. Muhammedit (a.s), me bindje e krenari legjitime!

Ju ftoj me zemër, ta përfetojmë si duhet këtë mirësi të madhe të rihapjes së lirisë së fesë, me lutjet më të sinqerta që kurrë mos ndodhtë që dikush të na poshtërojë në fenë tonë e, ne të heshtim, a (Zot na ruaj) të bëhemi palë!

*(Hytbe e mbajtur
në xhaminë e Parrucës)
Shkodër, më 30 tetor 2015*

U PËRKUJTUA 20 VJETORI I INAUGURIMIT TË XHAMISË “EBU BEKËR”

Ditën e martë, më 27 tetor 2015, pas namazit të iqindisë, në xhaminë “Ebu Bekër”, në Fushë Çelë, u organizua një aktivitet përkujtimor, me rastin e ditës së 20 vjetorit të inaugurimit të xhamisë së Madhe të Shkodrës.

Në ligjëratën e tij, imami i kësaj xhamie, teologu Idmir Plaku, foli mbi rëndësinë e kësaj xhamie, si dhe vlerën e madhe që ajo i jep qytetit të Shkodrës, duke dëshmuar shpirtin islam dhe mesazhet e tij qytetëruese.

Ai vuri theksin te vlera e xhamisë në shoqëri, si dhe pozita e rëndësishme e kësaj faltoreje të mrekullueshme, në qendër të qytetit.

Ndërsa imami i xhamisë Perash, teologu Adem Pizga, foli mbi vlerën e xhamive në jetën e muslimanëve, si dhe shpërblimin e frekuentuesve të saj, në këtë botë para të përtejmes.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, si dhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, që dhanë mesazhet e tyre me rastin e kësaj dite



dhe ngjarjes së madhe për Shkodrën dhe mbarë Shqipërinë.

Myftiu i Shkodrës, uroi edhe drejtuesit e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, duke theksuar se Xhamia e Madhe e Shkodrës, është vlerë për KMSH, sikurse data jubilarë e 20 vjetorit të saj, datë reflektimi dhe dëshmie për vetë KMSH.

Më herët, Myftiu falënderoi Familjen “Ez-Zamil”, nga Arabia Saudite, që kontribuoi për ndërtimin e kësaj xhamie,

sikurse u lut për krejt myftilerët, imamët, muezinët, shërbyesit, kontribuuesit dhe krejt besimtarët frekuentues të kësaj xhamie të dashur.

Aktiviteti u mbyll me urimet e teologut Arben Halluni drejtuar besimtarëve, për të cilët u shpërnda edhe një botim informues, enkas për këtë ditë, që ka të bëjë me historinë e vakëfit të kësaj xhamie, emërtimin e tij, zanafillën e emrit etj.

MYFTIU, LIGJËRATË MBI VLERËN E NAMAZIT TË NATËS

Mbrëmjen e së martës, më 27 tetor 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti një ligjëratë mbi vlerën e namazit të natës, me grupin e medresistëve që banojnë në konviktin e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, dega djem.

Pas mirëpritjes dhe një bashkëbisedimi të ngrohtë me drejtorin e kësaj vatre edukimi, teologun Gezim Dungaj, organizatorin e këtij takimi vlerash, Myftiu iu drejtua të pranishëmve, duke u lutur fillimisht për mbarësinë e tyre dhe suksese në kërkimin e dijes.

“Tema që kam përzgjedhur të flas sonte me ju ka një rëndësi të madhe, sidomos për kërkuesit e dijes, si dhe për krejt ata që duan të afrohen me All-llahun e Madhëruar dhe të përfitojnë nga mirësitë e Tij në këtë botë. Namazi i natës është një ftesë kur’anore dhe një traditë e fortë profetike! Hadithet që nxisin faljen e namazit të natës janë të larmishëm, të ndryshëm, të shumtë. Ata, janë një ftesë e bukur për të përfituar nga kjo dhunti hyjnore, sepse



arritjet dhe sukseset në jetë nuk mund të përftohen me gjumë, dembelizëm, përtaci e neglizhencë! Ju ftoj që duke nisur nga kjo natë, të falni, të paktën dy rekate namaz nate para vitrit të jacisë, do jetë një mrekulli!”- tha, ndër të tjera Myftiu.

Myftiu përmendi disa hadithe që lidhen me këtë temë, si: “Faleni namazin

e natës (kijamul-lejl), sepse ai ishte traditë e të parëve të mirë para jush. Ai është afrim me All-llahun e Madhëruar, ndalesë nga gjynahet, falje për gabimet dhe largim për sëmundjet në trup”.

Në fund, Myftiu falënderoi organizatorin e këtij takimi me vlerë, si dhe uroi suksese të mëtejshme për medresistët tanë.



Idmir Plaku

imam, xhamia "Ebu Bekër"

Sot, në këtë tubim simbolik përkujtojmë me krenari, një ditë të veçantë në historikun e kësaj xhamie, 20 vjetorin e inaugurimit të ndërtimit të saj. Çdo përvjetor i xhamive të ndërtuara në vitet e demokracisë na bën më të vetëdijshëm ne si besimtarë ndaj imazhit të atyre që i shkatërruan kundrejt atyre që i ndërtuan këto institucione e kulte fetare.

E falënderojmë Allahun e Madhëruar që këtë imazh të këtij kontrasti të qartë ndërmjet shkatërruesit dhe ndërtuesit e ruan në Kur'an duke thënë: "E kush mundet të jetë më mizor se ai që në xhamitë e Allahut pengon të përmendet emri i Tij dhe përpiket për shkatërrimin e tyre. Atyre ndryshe nuk u takoi të hyjnë vetë në to, vetëm duke qenë respektues (të tyre e jo rrënues). Ata në këtë jetë kanë nënçmim e në botën tjetër dënim të madh." (El-Bekare: 114)

Ndërsa në një ajet tjetër thotë: "E drejtë e përkujdesjes së xhamive të Allahut është vetëm e atij që i ka besuar Allahut dhe ditës së gjykimit e që e falë namazin, jep zekatin e nuk i friksohet askujt tjetër veç Allahut. Të tillë do të jenë të udhëzuarit (në rrugën e drejtë)." (Et-Tevbe: 18) Ky përvjetor i kësaj xhamie nuk është thjesht përkujtim i asaj dite që u bë inaugurimi i ndërtimit të saj. Sepse xhamia nuk është vetëm guri e minareja, nuk është vetëm ndërtimi i bukur, por mbi të gjitha është shprehje e shpirtit të lirë e të pastër, shprehje e frymës humane të Islamit.

Në të vërtetë kjo xhami ka qenë ndër të parat që regjimi i egër komunist e rrafshoi, por edhe ndër të parat që bujaria e shpirtit besimtar e ndërtoi. Ndërtimi i kësaj xhamie 20 vite më

REFLEKSIONE NE 20 VJETORIN E XHAMISË EBU BEKËR

parë dëshmoi frymën e solidaritetit dhe humanizmit të besimtarëve kudo që ata ndodhen, garojnë në lartësimin e fjalës së Allahut. Mesazhi që Allahu i Madhëruar u bëri të ditur besimtarëve ishte i qartë se ai që ndërton shtëpi ku përmendet emri i Allahut ka siguruar të mirën e kësaj bote dhe të tjetrës.

Akti i vendosjes së gurit të themelit e të ndërtimit të kësaj xhamie 20 vite më parë ka qenë jo vetëm një shuplakë e fortë ndaj atyre që e shkatërruan e që nuk e dëshironin në këtë vend, por edhe kontributi më i mirë për të ardhmen tonë ndërtuese të xhamive ku përmendet emri i Allahut. Ndërtimi i kësaj xhamie madhështore ka qenë nderimi më i mirë e më dinjitoz që iu bë Shkodrës dhe traditës së saj të pasur fetare.

27 tetori i vitit 1995 ka hyrë në historikun e xhamive, jo vetëm si datë e ndërtimit të kësaj xhamie, por edhe si një konfirmim bindës i identitetit të këtij qyteti dhe bashkëjetesës fetare të tij. E kjo falë pjesëmarrjes së madhe të besimtarëve në ditën e inaugurimit, por edhe të frekuentimit të vazhdueshëm të saj. Kjo datë do të thojë është historike për muslimanët në vendin tonë pas asaj të 16 nëntorit 1990.

Më ndërtimin e kësaj xhamie jo vetëm muslimanët e këtij qyteti, por kudo që ata ndodheshin u ndjenë krenar dhe shumë të respektuar. Atë vit ndodhesha në Siri për studime dhe jehonën e inaugurimit të saj e përjetova me shumë mall dhe me një ndjenjë gëzimi të veçantë. Pas dy javësh nga dita e inaugurimit të saj, lexova në një gazetë të përditshme arabe, "Muslimanët", përshkrimin e gjendjes fetare në vendin tonë dhe rolin që do të kishte kjo xhami në shoqëri. Prandaj ky 20 vjetor i inaugurimit të kësaj xhamie na e freskon kujtesën e atyre ditëve, të atyre personaliteve fetare, besimtarë e bamirës, që bënë të mundur ndërtimin e kësaj xhamie.

Kujtojmë faktin se xhamia e parë për nevojat e njerëzve u ndërtua në Mekë, si shenjë e mëshirës së Allahut dhe si burim i forcës shpirtërore të besimtarëve. Qabja hyri në kujtesën

e historisë njerëzore jo me kujtimin e ditës së parë të saj, por me atë të xhamisë së parë në tokë, e kjo si shprehje vullneti dhe besimi, si kjo e sotmja që me solemnitete e përkujtojmë.

Gabohen ata që e konceptojnë përkujtimin e këtyre datave apo ngjarjeve si "risi". E përkujtojmë këtë ditë si një rigjallërim të besimit e vullnetit të popullit, si një mençuri e atyre që morën vendimin e rindërtimit të saj në vendin e duhur, si një lumë i pashtershëm lëmoshe, jo vetëm i atyre që e dhuruan vakëf këtë truall, por edhe i atyre që e sponsorizuan ndërtimin e saj, edhe atyre që kontribuan në mirëmbajtjen e mirëfunksionimin e saj.

Si një ruajtje e historisë, traditave dhe vlerave kulturore e fetare në qytetin e vendin tonë. E përkujtojmë me një respekt të veçantë atë ditë, që për ne, me lejen e Allahut u lejua të madhërohet e lartësohet emri i Tij në këtë vend. E përkujtojmë ezanin e parë të asaj dite, që guxoi me leje të Allahut, ndezjen e dritës hyjnore në këtë vend. Dritë për të cilën Allahu i Madhëruar dëshmon për të duke thënë në Kur'an: "(ajo dritë) Është në shtëpitë (xhamitë) që Allahu lejoi të ngriten, e që në to të përmendet emri i Tij, t'i bëhet lutje Atij mëngjes e mbrëmje". (En Nur: 36)

Le të jetë përkujtimi i ditës së inaugurimit të kësaj xhamie kujtesë për çdo besimtar e besimtare, që të jetë më i vetëdijshëm për obligimet që ka ndaj Allahut në përgjigje të Tij në pesë kohët e thirrjes hyjnore nga lartësia e këtyre minareve. Të ruajmë jetën tonë duke qenë të përpiktë në këto kohë të thirrjes hyjnore. Çdo përvjetor është një kujtesë, por frekuentimi i xhamisë në kryerjen e ibadeteve është obligim hyjnor, është mirënjohja më e madhe ndaj atyre që kanë bërë të mundur ndërtimin e mirëmbajtjen e saj në këto 20 vite. Ky është vendi më i dashur tek Allahu (xh.sh) këto janë vende në të cilat merr forcë shoqëria besimtare. Së fundmi një lutje e veçantë për familjen "El-Zamil", Allahu (xh.sh) ua begatoftë pasurinë e tyre.

Shkodër, më 27. 10. 2015

MYFTINIA SHKODËR BËHET GATI PËR PROGRAMIN E 16 NËNTORIT

Pasdrekën e së enjtes, më 29 tetor 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të Shkodrës, me të cilët diskutoi fillimin e programit, me aktivitete të larmishme, në prag të 16 nëntorit 2015.

Myftiu tha se programi, me të cilin shpresohet t'i bëhet jehonë 25 vjetorit të rilejimit me ligj të lirisë fetare, duhet të ketë angazhimin maksimal të krejt imamëve, xhemateve dhe qytetarëve muslimanë të Shkodrës, pasi kjo ngjarje personifikon shpirtin e besimit të pashuar në zemrat e shkodranëve.

Në këtë takim u shpjegua programi i aktiviteteve, që nisin nga dita e nesërme, më 30 tetor 2015, ku në të gjitha xhamitë e Shkodrës do të mbahen hytbe, kushtuar sakrificës dhe vullnetit të pashembullt të rinisë dhe qytetarëve shkodranë, që në nëntor të vitit 1990, i



paraprinë proceseve demokratizuese të vendit, me hapjen e objekteve fetare.

U kërkua, që programi të prezantohet më së miri në të gjitha xhamitë e qytetit dhe fshatit, si dhe të ftohen besimtarët dhe qytetarët e Shkodrës

që të bashkohen në këto aktivitete, në përkujtim të 25 vjetorit të Xhamisë së Plumbit.

Ky takim u zhvillua në ambientet e xhamisë së Plumbit, ku më parë, imamët falën së bashku namazin e iqindisë.

Paraditën e xhumasë, më 30 tetor 2015, Myftinia Shkodër ka bërë publik programin e aktiviteteve të 25 vjetorit të rilejimit me ligj të fesë në vendin tonë, pas 23 vitesh persekutimi dhe dhune shtetërore ndaj islamit dhe muslimanëve, krejt besimtarëve dhe aktivitetit të tyre fetar.

Përpara mediave të pranishme, teologu Arben Halluni ka bërë të ditur se shumë aktivitete do të zhvillohen në harkun kohor (30 tetor – 16 nëntor 2015), në përkujtim të mirësisë së madhe të lirisë së besimit në Shkodër e mbarë Shqipërinë.

Më poshtë, programi me aktivitetet kryesore të tij:



 KALENDARI I AKTIVITETEVE ME RASTIN E 25-VJETORIT TË RIHAPJES SË XHAMISË SË PLUMBIT, SHKODËR (30 tetor -16 nëntor 2015)	
30.10.2015	Hytbeja e xhumasë në të gjitha xhamitë e Shkodrës i kushtohet sakrificës dhe vullnetit të pashembullt të rinisë dhe qytetarëve shkodranë, që në nëntor të vitit 1990, i paraprinë proceseve demokratizuese të vendit, me hapjen e objekteve fetare.
1.11.2015	Ceremonia përkujtimore: "Mirënjohja e Qytetit", Myftiut të Shkodrës, H. Xhemal Çanga. (aktiviteti zhvillohet në bibliotekën e qytetit, pranë xhamisë Parrucë, ora: 17.00 – ftesë e hapur).
2.11.2015	Aktiviteti përkujtimor: "Këshilla të një hytbeje, sa një amanet", kushtuar Myftiut të Shkodrës, H. Faik Hoxha. (aktiviteti zhvillohet në kinema "Millenium", ora: 17.00 – ftesë e hapur).
3.11.2015	Bashkëbisedim me Myftiun e Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj. (aktiviteti zhvillohet tek sala e konferencave e konviktit të Medresës "Haxhi Sheh Shamia", dega djem, ora 17.00 – ftesë e hapur).
4.11.2015	Inaugurimi i xhamisë së fshatit Mes-Myselim. (ceremonia zhvillohet në orën 11.00).
5.11.2015	Inaugurimi i përfundimit të restaurimit të xhamisë në kalanë e Drishtit. (ceremonia zhvillohet në orën 11.00).
6.11.2015	"Nostalgi dhe mall për Hoxhën tonë, Hafiz Sabri Koçi". (aktiviteti zhvillohet në xhaminë e Rusit, në orën 12.00).
9.11.2015	Vizitë tek shtëpia e imamit të nderuar, Hafiz Sulejman Kraja. (ora: 16.30. Myftiu me Këshillin e Myftinisë Shkodër).
10.11.2015	Inaugurimi i pllakatës tek ndërtesa e ish-Myftinisë Shkodër, pas vitit 1990. (ora: 11.00. Shtëpia e familjes Baja, rruge e gjerë, pranë stadiumit).
11.11.2015	Vizitë tek shtëpia e familjes Myftija, lagja "Tabakë", pranë xhamisë së Plumbit. (ora: 16.30. Myftiu me Këshillin e Myftinisë Shkodër).
12.11.2015	Ekspozita e botimeve të hoxhallarëve, imamëve dhe thirrësve islamë shkodranë në 25 vitet e fundit dhe promovimi i librit "Zidni", nga Imam Muhamed Sytari, Myfti i Zonës Shkodër. (aktiviteti zhvillohet në bibliotekën e qytetit, pranë xhamisë Parrucë, ora: 17.00 – ftesë e hapur).
13.11.2015	E xhumaja masive për të gjitha xhamitë e qytetit, tek sheshi i xhamisë së Plumbit, në orën 12.00. (për ata që nuk kanë mundësi qarkullimi me mjete personale, autobuzët në dispozicion nisen në orën: 11.30, pranë xhamisë së Parrucës).
14.11.2015	Konferenca: "25 vjet liri besimi – sfida, sprovë, perspektivë". Referojnë: Dr. Genti Kruja, (drejtor i kulturës dhe dialogut ndërfaqësor, KMSH), Msc. Anduena Defalia (pedagoge, C.I.T.), Artur Tagani (PhD candidate, U.E.T), Lavdrim Hamja (imam, Myftinia Shkodër) (aktiviteti zhvillohet te sala e konferencave, te hotel "Colosou", ora: 11.00).
16.11.2015	Inaugurimi i pllakatës tek shtëpia e familjes Myftija, lagja "Tabakë", ora: 11.00. Falja e namazit të mesditës me xhamat dhe Dua për hoxhallarët dhe besimtarët e shkuar, ora: 11.30. Shfaqja e dokumentarit kushtuar rihapjes së Xhamisë së Plumbit, më 16 nëntor 1990, në teatrin "Migjeni", ora: 17.00. Përsëritet protokollare. Fjala përshëndetëse nga H. Skender Bruçaj, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Program artistik i Medresës "Haxhi Sheh Shamia", me lahi dhe recitime.

HAFIZ XHEMAL ÇANGA, NDEROHET MYFTIU I SHKODRËS (1959-1967)

Pasditën e së dielës, më 1 nëntor 2015, Myftinia Shkodër ka organizuar në bibliotekën e qytetit, ceremoninë e akordimit të titullit: “Mirënjohja e Qytetit”, për Myftiun e Shkodrës (1959-1967), Hafiz Xhemal Çanga.

Ceremonia është përshëndetur nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili ka vlerësuar këtë aktivitet si një dëshmi e ruajtjes së besës së të shkuarve, si dhe një nderim për myftiun e fundit të Shkodrës, deri në vitin e errët 1967.

“Përkujtimi i personalitetit të Myftiut Hafiz Xhemal Çanga, na bën mirë të gjithëve, sepse në një mënyrë a tjetër, me përkujtimin e emrit të Hirësisë së tij dhe të brezit që i takonte, ne trashëgojmë tek e sotmja, e veçanërisht te rinia dhe fëmijët tanë, respektin dhe nderimin për këta burra të sprovuar në fë!” - tha Myftiu.

Aktiviteti vijoi me referatin e mbajtur nga H. Fejzi Zaganjori, imam i xhamisë Rus, i cili hodhi dritë mbi jetën dhe kontributin e të nderuarit H. Xhemal Çanga.

“Hafiz Xhema, ashtu si është njohur në rrethet muslimane të Shkodrës, ka qenë një njeri fisnik, i besës dhe krejtësisht i



ndershëm ndaj misionit të besimit dhe fesë islame, që i shërbeu me shumë përkushtim në momentet më të vështira të historisë sonë kombëtare. Pavarësisht kërcënimeve dhe tundimeve të ndryshme të komunistëve, Hafizi i nderuar e ruajti dinjitetin e tij dhe të misionit që përfaqësonte, ndonëse kjo i kushtoi poshtërim nga pushteti dhe dënim me punë në një prej reparteve të zdrukhtarisë.” - tha, ndër të tjera, H. Fejzi Zaganjori.

Me shumë emocion u ndoq momenti i akordimit të titullit: “Mirënjohja e

Qytetit”, që iu dorëzua të bijës së Myftiut Hafiz Xhemal Çanga, nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë Shkodër, z. Xhemal Bushati.

Ndërkohë, në emër të familjes përshëndeti z. Rauf Çanga, i cili falënderoi Myftininë Shkodër dhe Këshillin e Bashkisë për këtë vlerësim të bërë për njeriun e tyre të dashur.

Në fund, teologu Arben Halluni, theksoi se ky aktivitet, që vjen në atmosferën e përkujtimit 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë në Shkodër, do të pasohet me aktivitete të shumta e të larmishme.

Aktiviteti përkujtimor: “Këshilla të një hytbeje, sa një amanet”



Pasditën e së hënës, më 2 nëntor 2015, Myftinia Shkodër ka shfaqur në kinema “Millenium”, hytben e fundit të mbajtur nga Myftiu i Shkodrës (1991-2003), H. Faik Hoxha (1930-2011).

Aktiviteti në fjalë vjen në vazhden e programit të larmishëm të përkujtimit të 25 vjetorit të rilejimit të fesë me ligj në vendin tonë.

Për rreth 30 minuta, të pranishmit patën mundësinë të ndiqnin hytben e fundit të mbajtur nga H. Faik Hoxha, rreth temës së teuhidit dhe kuptimeve të fjalës së Njesisë: “La ilahe il-lall-llah”.

Hytbeja në fjalë ishte e mbushur me argumente kur’anore dhe hadithe profetike, që nxisin shtimin e dhikrit dhe përmendjes së vazhdueshme të Allahut në jetë.

Hytbeja e fundit e mbajtur në jetën e Myftiut H. Faik Hoxha, ishte si një amanet i shtrenjtë besimi dhe përkushtimi ndaj Zotit dhe fesë së Tij në jetë, që i drejtohet të gjithë besimtarëve.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili tha se programi i aktiviteteve të 25 vjetorit të lirisë së besimit, nuk do të kishte kuptim pa këtë mbrëmje përkujtimore në nder të Myftiut të nderuar H. Faik Hoxha dhe kujtimit të tij.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe znj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër, z. Xhemal Bushati, Kryetar i Këshillit të Bashkisë Shkodër, H. Edmir Smajlajj, Myfti i Malësisë së Madhe, H. Agim Terziu, Myfti i Lezhës, z. Kujtim Dervishi, Drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, z. Ridvan Seferaj, Kryetar i Shoqatës “Istanbul”, z. Sokol Mandi, Drejtori i Shoqatës “Burimi”, si dhe shumë intelektualë, imamë, familjarë të Myftiut rahmetli e besimtarë të shumtë.

“NDERIMI I MYFTIUT HAFIZ XHEMAL ÇANGA, NDERIM PËR MBARË SHKODRËN!”

Të nderuar të pranishëm,
Është në nderin tim dhe të Myftinisë Shkodër, të përshëndes sonte këtë ceremoni, ku Myftiut të nderuar, Hafiz Xhemal Çanga, i akordohet titulli “Mirënjohja e Qytetit”, pas vdekjes, pikërisht në këtë nëntor të këtij viti, kur bashkërisht përkujtojmë 25 vjetorin e rihapjes së xhamisë së Plumbit dhe organizimit masiv të xhumasë së parë në liri, pas 23 vjet persekutimi, dhunimi dhe ndalimi me ligj të fesë tek ne.

Kjo ceremoni nderimi dhe përkujtimi në nder të Myftiut të Shkodrës, Hafiz

me përkujtimin e emrit të Hirësisë së tij dhe të brezit që i takonte, ne trashëgojmë tek e sotmja, e veçanërisht te rinia dhe fëmijët tanë, respektin dhe nderimin për këta burra të sprovuar në fë!

Si të thuash, rasti i tyre na shërben për t’u lidhur edhe më shumë me Islamin tonë, pikërisht sot në kohën kur islamofobia dhe osmanofobia, po “lulëzojnë” në vendin tonë dhe dëshmimi i Islamit në tokën dhe vendin e tij, po kthehet në ndjenjë e çuditshme kompleksi tek disa.

Hafiz Xhemal Çanga i përket atyre



Xhemal Çanga, është në të vërtetë një shenjë respekti për mbarë muslimanët e Shkodrës, për vetë qytetin e, mbi të gjitha, për atë brez besimtarësh, imamësh e myftilerësh, që u sprovuan në jetën e tyre me fitnen më të frikshme e më të dhimbshme, atë të privimit nga liria fetare.

Është një Mirënjohje, që ia kemi borxh imamëve dhe myftilerëve tanë të sprovuar, një dëshmi e ruajtjes dhe mbrojtjes së amanetit të tyre, me të cilin u larguan nga kjo botë, me zemër të thyer e me shpresën e pashuar për triumfin e besimit, me të cilin jetuan e të cilit i shërbyen sa ishin në këtë botë.

Përkujtimi i personalitetit të Myftiut Hafiz Xhemal Çanga, na bën mirë të gjithëve, sepse në një mënyrë a tjetër,

burrave, për të cilët, në Kur’an thuhet: “Ata janë burra, që ishin të singertë në besën që i dhanë All-llahut...” – (El-Ah’zab, 23).

Ai u largua nga kjo botë pa një xhenaze të merituar, pa një “Fatiha” me xhemat, pa një hatme e një përkujtim të denjë. Ju ftoj, në nderim të tij, të ngrihemi në këmbë dhe të lexojmë bashkarisht një “Fatiha” për shpirtin e tij!

Faleminderit!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

(Fjala e rastit në ceremoninë e dhënies së titullit Mirënjohja e Qytetit,

Myftiut Hafiz Xhemal Çanga)

Shkodër, më 1 nëntor 2015

TRIBUNA FETARE PËR MOTRAT MUSLIMANE



Paraditën e së shtunës, më 7 nëntor 2015, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë “Ebu Bekër”, një tribunë fetare për motrat muslimane.

Aktiviteti në fjalë, vjen në atmosferën e programit të larmishëm të 25 vjetorit të rilejimit të fesë në vendin tonë, si dhe 20 vjetorit të xhamisë së Madhe të Shkodrës.

Në këtë tribunë fetare ligjëruan teologët Ferzet Ndoja, Jetmira Plaku dhe Zamira Puka, të cilat u përqendruan tek rëndësia që ka ndjenja e besimit dhe lidhja me Zotin në jetën e besimtares, si bazë suksesi dhe mbarësie.

Vaizet e nderuara, vlerësuan faktin e lirisë së besimit dhe praktikimit të tij, si mundësi për edukimin e fëmijëve dhe dëshmimin e identitetit islam haptas, pa asnjë ndrojtje dhe frikë paragjykimi në shoqëri.

Pas namazit të mesditës me xhemat, u organizua edhe dua ja e hatmes së Kur’anit, me rastin e këtij tubimi të begatë.



Pasditën e së martës, më 3 nëntor 2015, Myftinia Shkodër organizoi një tubim me temë: “Bashkëbisedim me Myftiun e Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj”.

Pas përshëndetjeve të rastit, nga teologu Arben Halluni, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Pukës, z. Gëzim Kopani dhe Drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi, fjalën e mori Myftiu i ftuar në këtë bashkëbisedim vlerash.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu i nderuar u ndal te vlera që ka përkujtimi i ngjarjes historike të rilejimit me ligj të fesë në vendin tonë, rihapja e xhamisë së Plumbit dhe aktivitetet që pasuan.

Myftiu i nderuar bëri një prezantim të aktivitetit të Myftinisë së Malësisë së Madhe, që në fillimet e saj ishte pjesë e Myftinisë Shkodër.

“Xhamia e parë pas xhamisë së Plumbit, ishte ajo në fshatin Linaj, që u pasua nga aktiviteti në xhaminë e Vrakës, ku akoma sot ruhen tjegullat me emrin e donatorit shkodran që para vitit 1967.

E para xhami e ndërtuar në Malësi të Madhe, pas vitit 1990, është ajo e Koplikut Qendër, me donacion të H. Burhan Filit. Ajo u pasua me xhami të reja në Jubicë, Gruemirë, Zagorë, Gradiskije, Ktosh, Reç etj.

Mbledhjet dhe takimet e para, imamët e Malësisë së Madhe i kanë bërë në Myftininë e Shkodrës, nën drejtimin e

BASHKËBISEDIM ME MYFTIUN H. EDMIR SMAJLAJ...



Myftiut H. Faik Hoxha.

Në vitin 2011 nisëm ndërtimin e xhamive të reja pas një periudhe pushimi të gjatë. Sot, falë Zotit, kemi 24 xhami. Në periudhën 2011-2015 janë ndërtuar 9 xhami të reja, falë angazhimit dhe bashkëpunimit me shoqata dhe fondacione të ndryshme.” - tha Myftiu.

Më pas, ai foli edhe për mirësinë e besimit dhe rëndësinë që ka lidhja, përherë e më tepër me mësimet dhe parimet e tij.

“Islami është plotësuar, nuk ka asgjë që

mungon në Fjalën e All-llahut, në Kur'an, as në fjalët e të dërguarit (a.s). Mirëpo, ne si muslimanë e kemi për detyrë sot të lexojmë, të kuptojmë, të praktikojmë sa të mundemi të mirën e Zotit, me të cilin na ka nderuar me këtë Islam të mrekullueshëm.” - tha, ndër të tjera.

Pas përfundimit të fjalës së Myftiut të Malësisë së Madhe, u zhvillua edhe një bashkëbisedim rreth temës së këtij tubimi, në kuadër të programit të 25 vjetorit.

U INAUGURUA XHAMIA E RE NË FSHATIN MES-MYSELIM



Paraditën e së mërkurës, më 4 nëntor 2015, Myftinia Shkodër ka organizuar ceremoninë e inaugurimit të xhamisë së re në fshatin Mes-Myselimi, në Postribë.

Në fjalën hapëse, teologu Arben

Halluni, tha se kjo ceremoni vjen si pjesë e larmishme e programit të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, si dhe si një shenjë besimi dhe përkushtimi për besimtarët e kësaj zone dhe të mbarë Shkodrës.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, i cili mbajti edhe fjalën e rastit, ku shprehu emocionet dhe gëzimin e tij për këtë vepër, që gëzon krejt komunitetin dhe mbarë Postribën muslimane.

Ceremonia u përshëndet edhe nga H. Edmir Smajlaj, Myftiu i Malësisë së Madhe. Në fjalën e tij, Myftiu Smajlaj tha se në ditën e gjykimit, kjo tokë do të dëshmojë për besimin dhe përkushtimin e besimtarëve të kësaj zone. Njëkohësisht, uroi të pranishmit me rastin e kësaj dite të begatë.

Një recitim i bukur nga medresisti Enis Rexha, e zbukuroi edhe më shumë këtë ceremoni, që kulmoi me prerjen e shiritit dhe faljen e namazit të mesditës me xhemat.

Në fund të namazit, Myftiu i Shkodrës bëri një lutje për të gjithë kontribuesit e kësaj xhamie, si dhe për të gjithë ata besimtarë që janë ndarë nga kjo jetë, para kësaj dite historike për fshatin Mes-Myselimi dhe zonën e Postribës.



E XHUMAJA SA 25 VITE



E NJË DITE, DËSHMI...



Paraditën e së enjtes, më 5 nëntor 2015, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” dhe Shoqatën “Istanbul”, ka organizuar ceremoninë e inaugurimit të xhamisë së re në kalanë e Drishtit.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe z. Hidayet Bayraktar, ambasador i Turqisë në vendin tonë, prof. dr. Birol Çetin, koordinator i përgjithshëm i TIKAs në vendin tonë etj.

Ceremonia, që ngjante si një festë e bukur, nisi me fjalën e rastit nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në të cilën falënderoi kontribuuesin nga Turqia, si dhe të gjithë ata që mundësuan që sot ta kemi këtë xhami të bukur, që kishte mbetur në mëshirë të fatit dhe neglizhencës së dekadave të shkuara.

Myftiu falënderoi donatorët turq, duke theksuar se në mes dy popujve, ka shumë emërues të përbashkët, që janë ura lidhëse shekullore, që sa vijnë e forcohen dhe konsolidohen. Njëkohësisht vlerësoi praninë e ambasadorit turk, si shenjë nderimi dhe vlerësimi për këtë ceremoni dhe krejt Shkodrën.

Ndër të tjera, Myftiu tha: “Sot, nga kjo minare nazike, ezani do të thërrasë pesë herë në ditë drejt forcimit të besimit dhe dëshmitit të Islamit në jetë, pa ndrojtje e frikë, pa hezitim e luhajtje, për të jetuar e

U INAUGURUA XHAMIA E RE NË KALANË E DRISHTIT



dëshmuar se nuk ka Zot tjetër, pos All-llahut, Krijuesit të vetëm të gjithësisë!”

Me këtë rast, Myftiu i dhuroi ambasadorit të Turqisë, z. Hidayet Bayraktar, simbolin e 25 vjetorit të rilejimit me ligj të fesë në vendin tonë.

Ndërkohë, në fjalën e tij, ambasadori turk, falënderoi organizimin e kësaj ceremonie, si deh donatorin nga Konya, i cili u bë shkak për këtë mirësi të madhe.

Ambasadori Bayraktar theksoi se miqësia gjashtëshekullore e dy popujve tanë, është garanci për një bashkëpunim edhe më të

madh në të ardhmen.

Ceremonia u përshëndet edhe nga z. Ridvan Seferaj, Kryetar i Shoqatës “Istanbul”, i cili vuri theksin te rëndësia e qëndrimeve në krah të besimit dhe përpjekjes për të jetuar e punuar me vlerat e tij. Ai falënderoi bashkëpunimin me Myftininë e Shkodrës, si dhe kontributin e vyer të donatorit bamirës, që dha nga pasuria e tij për restaurimin e kësaj xhamie.

Pas prerjes së shiritit, pjesëmarrësit ndoqën programin e bukur artistik nga nxënësit e medresesë dhe falën bashkërisht namazin e mesditës.

“NOSTALGJI DHE MALL PËR HOXHËN TONË, HAFIZ SABRI KOÇI”

Ditën e xhuma, më 6 nëntor 2015, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë e Rusit, një ceremoni përkujtimore, në nder të personalitetit dhe shembullit të Hoxhës së dashur, Hafiz Sabri Koçi.

Aktiviteti nisi me fjalën e rastit nga imami i xhamisë Rus, H. Fejzi Zaganjori. Gjatë saj, ai prezantoi aktivitetin dhe simbolikën e aktivitetit fetar të Hafiz Sabriut, persekutimin në burgjet e komunizmit, si dhe udhëheqjen e dhjetra mijëra besimtarëve muslimanë, që me 16 nëntor 1990, sinjalizuan fillimin e një epoqe të re për vendin dhe kombin.

H. Fejzi Zaganjori tha se emri i H. Sabri Koçit, mbetet një stacion i rëndësishëm në jetën e muslimanëve shqiptarë, sidomos në këto 25 vite.

Aktiviteti vijoi me ritet e xhumasë, hytben e së cilës e mbajti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari. Në këtë mesazh të javës, Myftiu u përqendrua te personifikimi i personalitetit të Hafiz Sabri Koçit, si një durimtar e qëndrestar, që triumfoi me besimin dhe thirrjen e tij.

Ndër të tjera, Myftiu tha: “Jam emocionuar shumë mbrëmë, teksa ndiqja me vëmendje historinë thuajse të pabesueshme të



vuajtjes dhe dhembjes së Hafiz Sabri Koçit durimtar e qëndrestar (që herë më ngjante me Hz. Ejubin (a.s), në durimin e sprovës së tij, e herë me Ebu Hanifen, teksa qëndronte i palëkundur në qëndrimet e tij, në burgjet e sprovës), tamam si të shihja copëza të personifikuar nga dhembja dhe sprova e Hz. Jusufit (a.s), në jetën e talebes së spikatur të elitës së fundit të hoxhallarëve të Shkodrës, në gjysmën e dytë të shekullit XX...”

Ceremonia e sotme përkujtimore, vjen në vazhdim të aktiviteteve të larmishme të 25

vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, e para xhami që nisi aktivitetin e saj fetar, pas 23 vitesh ndalimi të fesë në vendin tonë.

Në këtë xhuma kushtuar Hafiz Sabri Koçit, i pranishëm ishte edhe z. Maxhid Cungu, nën/kryetar i Këshillit të qarkut Shkodër, teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Arben Halluni, H. Mithat Myftija, imam i xhamisë së Plumbit, antarë të Këshillit të Myftinisë Shkodër, familjarë të Hafizit të nderuar etj.

Pasditën e së hënës, më 9 nëntor 2015, Këshilli i Myftinisë Shkodër dhe Myftiu, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilluan një vizitë në shtëpinë e Hoxhës së nderuar, Hafiz Sulejman Kraja (1921-2006).

Kjo vizitë vjen në atmosferën e begatë të 25 vjetorit të rilejimit të fesë në vendin tonë, ndërkohë që Hoxha i nderuar ishte një ndër imamët dhe hoxhallarët e pakët, që i kishin shpëtuar periudhës së errët të persekutimit ateist në vendin tonë.

Në pritje të Myftiut dhe këshilltarëve të Myftinisë Shkodër, ishte bashkëshortja e Hoxhës së nderuar dhe familjarët e tij, që falënderuan këtë vlerësim për njeriun e tyre të dashur, Hafiz Sulejman Kraja.

Ata kujtuan momente të paharruara nga jeta e tij, sakrificat dhe përkushtimi i madh, sidomos gjatë periudhës së errët së femohimit, kur iu kërkua të mohonte Zotin dhe fenë, gjë të cilën nuk e pranoi asnjëherë, duke dëshmuar karakterin e tij të fortë dhe qëndrueshmërinë e muslimanit dhe thirrësit islam.

Gjatë vizitës, Myftiu tha se kjo vizitë

VIZITË NË SHTËPINË E HOXHËS HAFIZ SULEJMAN KRAJA



është shenjë nderimi dhe respekti që Myftinia Shkodër i detyrohet shërbimeve dhe përkushtimit të madh të Hoxhës, H. Sulejman Kraja, që për shumë vite ishte imam, vaiz dhe hatib i xhamisë së Kirasit, e para xhami qytetëse, pas viteve '90.

Ai tha se nga duart e Hafizit, që u diplomua nga H. Muhamed Bektashi,

dolën shumë djem e vajza, që më pas do të vazhdonin studimet teologjike në vende të ndryshme të botës islame.

Myftiu tha se Hafizi ishte njeri i heshtur në punën e tij dhe se sot, në këtë 25 vjetor të rilejimit të fesë në vendin tonë, Myftinia Shkodër e ka për nder ta kujtojë për mirë dhe t'i shprehë atij mirënjohje dhe respekt!

PLLAKATË PËRKUJTIMORE TE SELIA E PARË E MYFTINISË SHKODËR

Paraditën e së martës, më 10 nëntor 2015, Myftinia Shkodër organizoi një ceremoni simbolike për zbulimin e pllakatës përkujtimore, te shtëpia e familjes Baja. Në fillimit e aktivitetit fetar, pas vitit 1990, ky objekt shërbeu si seli e Myftinisë Shkodër dhe Bashkësisë Islame të Shqipërisë.

Pas zbulimit të pllakatës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, tha se kjo shtëpi, ka një simbolikë të rëndësishme për Myftininë e Shkodrës, pasi në vitet e para të rimëkëmbjes fetare, ajo ishte pikë referimi për muslimanët shkodranë, qendra e Myftinisë Shkodër, faltarja e parë qytetëse dhe seli e Bashkësisë Islame të Shqipërisë.

Myftiu falënderoi z. Rexhep Baja, pronar i kësaj shtëpie, për mirëkuptimin dhe gatishmërinë e



tij për vendosjen e kësaj pllakate përkujtimore në muret e pronës së tij.

Nga ana e tij, z. Baja, shprehu falënderimet e tij për Myftininë Shkodër dhe vlerësoi këtë nderim dhe

respekt për të dhe familjen e tij.

Në këtë ceremoni merrni pjesë imamë, intelektualë e qytetarë të nderuar shkodranë, që shprehën vlerësimin për këtë përkujtim të mirë.

VIZITË NË SHTËPINË E FAMILJES MYFTIJA, NË LAGJEN TABAKË

Pasditen e së mërkurës, më 11 nëntor 2015, Këshilli i Myftinisë Shkodër dhe Myftiu, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilluan një vizitë në shtëpinë e familjes Myftija, në lagjen Tabakë, bri xhamisë së Plumbit.

Me rastin e kësaj vizite, në pozitën e mikpritësit, H. Mithat Myftija, shprehu kënaqësinë e tij dhe të familjes Myftija, për këtë nderim të Myftinisë Shkodër, në prag të përkujtimit të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit.

Z. Myftija theksoi se kjo vizitë ka një domethënie të madhe për të, vëllezërit dhe familjen e tyre, pasi 25 vite më parë, në këtë shtëpi hyri Hafiz Sabri Koçi, në prag të asaj dite të madhe e të paharrueshme të 16 nëntorit 1990.

Gjatë kësaj vizite, u sollën në kujtesë momentet e para të përgatitjes së xhamisë së Plumbit për ceremoninë e madhështore të datës 16 nëntor 1990, vështirësitë, pengesat, angazhimin e qytetarëve dhe tubimin e tyre, deri në momentin kulminant, që u pasua me tubime e takime të vazhdueshme në këtë shtëpi.



Nga ana e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vlerësoi këtë vizitë si pjesë e programit të përkujtimit të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë Plumbit, si dhe si një vlerësim për familjen Myftija, por edhe për të gjithë ata, që iu bashkuan punës për përgatitjen dhe finalizimin e ceremonisë së 16 nëntorit.

Me këtë rast, Myftiu i dorëzoi z. Mithat Myftija, një pllakatë mirënjohjeje të

Myftinisë Shkodër për familjen Myftija, në nderin dhe respekt të përkushtimit dhe angazhimit me rimëkëmbjen e xhamisë së Plumbit.

E pranishme në këtë vizitë ishte edhe znj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër, e cila shprehu vlerësimet dhe respektin e saj për familjen Myftija dhe ngjarjen e shënuar të rihapjes së xhamisë së Plumbit, 25 vite më parë.

U PROMOVUA LIBRI “ZIDNÍ”, NGA IMAM MUHAMED B. SYTARI

Pasditën e së enjtes, më 12 nëntor 2015, Myftinia Shkodër, organizoi në ambientet e bibliotekës së qytetit, promovimin e librit më të ri nga Imam Muhamed B. Sytari, me titull: “Zidnî”.

Ceremonia e promovimit të librit nisi me analizën e librit, nga shkrimtari Xhahid Bushati, i cili hodhi dritë mbi librin si dhe krijimtarinë e autorit, duke vlerësuar se botimi në fjalë është pjesë e një pune të përhapur në kohë.

Gjatë analizës së këtij botimi, z. Bushati bëri një lidhje në mes librit “Zidnî” me pararendësin e tij, “Nún Pasha Lapsin...”, që janë pjesë e pandashme e marrëdhënies së autorit me dy periudha të drejtimit të tij të Myftinisë Shkodër.

Libri i ri nga Imam Muhamed B. Sytari, ndahet në pesë kapituj: Studime, Ese, Intervista, Mesazhe dhe derse, si dhe Thirrje shpirti.

Një përshëndetje plot emocion ishte edhe ajo e bërë nga thirrësi islam, me banim në ShBA, H. Burhan Fili, i cili vlerësoi punën e teologëve të rinj dhe falënderoi autorin për këtë libër të ri, si dhe botimet e mëparshme.

H. Burhan Fili tha se Shkodra, përherë ka pasur njerëz të penës dhe autorë,



që nuk janë kursyer për të përhapur dije dhe vlera islame. Njëkohësisht ka ftuar teologët që të punojnë me sa të kenë mundësi, në rrugën e përhapjes së diturisë dhe qytetërimit islam.

Në përfundim, autori i librit, Imam Muhamed B. Sytari, tha se ndjehet i lumtur dhe i emocionuar njëkohësisht, që promovimi i këtij libri vjen si pjesë e zinxhirit të aktiviteteve të larmishme që Myftinia Shkodër po zhvillon në kuadër të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit.

Autori falënderoi të pranishmit në

këtë promovim, si dhe shkrimtarin Xhahid Bushati për përkujdesjen e tij në redaktimin e këtij libri, Shtëpinë botuese “Focus print”, pjesë e LOGOS-A, si dhe z. Sami Gharbi (Tunizi) për kurimin e kopertinës.

Aktiviteti vijoi me prezantimin e një ekspozite me botimet e hoxhallarëve, imamëve dhe thirrësve islamë shkodranë në këto 25 vite. Gjatë këtij ekspozimi me vlerë, dhanë mesazhet dhe vlerësimet e tyre teologu Arben Halluni dhe imami i xhamisë së Rusit, H. Fejzi Zaganjori.

Xhahid Bushati, *shkrimtar*

“Realitetet tona janë nevojtare për më shumë dije, për më tepër urtësi e, mbi të gjitha, për më tepër vullnet për t’u lutur me zemër: “Zidni”, në rrugën e ndërtimit dhe mbrojtjes nga preket e errësirës së padijes” - (Pjesë nga parathënia “Përse “Zidni”?, të librit me titull “Zidni” të autorit Muhamed Bardhyl Sytari, botuar nga Focus Print – Shkup, 2015)

“Zidni” është botimi më i ri i Thirrësit islam Muhamed Sytari. Ky botim, ashtu si shumica e krijimtarisë së këtij autori, më parë kanë qenë të njohura për mua që në dorëshkrimet e tyre. Kështu që nuk mund të bënte përjashtim dhe ky i fundit i botuar pak kohë më parë, por jo i fundit.

Unë nuk do të marr përsipër të tregoj marrëdhëniet me tekstin, botën dhe imazhet e ofruara apo për ndjesitë që përftoj gjatë leximit si shkrimtar, lexues e redaktor i librit “Zidni”, më parë në dorëshkrim. Këto ndjesi deri në një farë mase nuk mund të shpjegohen, sepse elementi hyjnor është i pranishëm. Por ndjesitë dua t’i shoh edhe në një qasje tjetër, figurativisht t’i copëzoj si përftesa që kam nga çdo libër i autorit, pastaj t’i përmbledh duke evidentuar disa elemente të përbashkëta të përcjella tek unë dhe tek lexuesi si mesazhe të rëndësishme. Të mos harrojmë se librat e këtij autori të botuara në vite, pra çdo krijim ruan dhe veçoritë e tij dhe, kjo është e lidhur me materialin që sjell dhe përcjell. Po rikthehem edhe një herë te ndjesitë. Nuk kam se si ta fsheh emocionin që më fal, butësinë e shpirtit që më dhuron, drithërimën lirike, hapësirën fatlume, ecurinë drejt progresives së këtij autori, vlerat që sjell, kulturën që manifeston, temat dhe problemet që trajton, artikulin e bukur të gjuhës shqipe, frazeologjinë e pasur dhe figuracionin, ku e lyp nevoja,

"ZIDNI" – NJË LUTJE PËR MUA, PËR TY, PËR TË GJITHË...

poetike, një poetikë të dashtun! Dhe dua të ndalem te një pjesë e frazës së mësipërme: “artikulimi i bukur i gjuhës shqipe”. Këtu dua të citoj një thënie të studiuesit Astrit Cani, i cili thotë: “Jo vetëm mbrenda politikës, por edhe mbrenda letrave duhet me ndejtë në shmang. Në mënyrë që mos me u zyrtarizue kurr, as në gjallje as në dekë, tue ruejtë pra gjanë ma të randsishme n’art: vitalitetin. Vitalitetin si cilësi e mbrendshme e punës tande. Çdo jetë që mundesh me i dhanë veprës, duhet me e marrë prej gjuhës, prej zemrës së gjuhës. Nuk ka jetë te shteti, as te turma, as te shkolla. Jetë ka te gjuha.” E, për ata që e kanë lexuar librin, si dhe për ata që do ta lexojnë, shpresoj të diktojnë ato shenja që kam diktuar unë gjatë leximit dhe studimit të librit “Zidni”, që përmbledhtas po i them: *Autori e artikulon bukur e gjallërueshëm, plot dritë e ngjyrë gjuhën shqipe. *Ruan në artikulin: Vitalitet. *Shpreh urtësi fjale. *Komunikimi prej shpirti dhe zemre me plot personazhe hoxhallarësh të nderuar. *Përcjellë mësimet, porositë, ixhazetet e shumë hoxhallarëve të ditur e të urtë. *Autori hedh dritë në veçanti për identitetin islam e në përgjithësi për identitetin e shqiptarëve. *Libri na paraqitet si visar, ku shpaloset rrezatimi dhe rrezeveprimi i tij.

Dhe të gjitha këto e plot të tjera më konkludojnë se, autori Muhamed Sytari në profilin e tij studimor teologjik është i veçantë, çuditërisht ende i pastudiuar. Studiuesit nuk duhet të mungojnë, po ashtu edhe studimet. Biblioteka e librave të tij autorial, nga viti në vit është konfiguruar me një frymëmarrje të gjerë problematike, me një ndërlidhje të ngushtë me realitetin dhe realitetet, me një pasuri dokumentare, shënimore, bashkëbiseduese me libra në gjuhë të huaj, etj., etj. Si e tillë ajo rrezaton diturisht dhe, autori Muhamed Sytari rri dinjitetshëm duke përcjellë mesazhe të rëndësishme jetike për myslimanët e më gjerë, si gjithnjë duke shpalosur parimet e tij drejtuese, dëshmuuese, obliguese, prijëtare, etj., të cilat e kanë burimin në Shkollën e Thirrjes Islame. E duke parë procesin krijues refleksi i librave të botuar, është e pamundur të mos dallosh disa fjalë kyçe, të cilat të marra së bashku shprehin thelbin e

rrugës e të tekstit rrëfimtari të autorit si individualitet i mirëpërcaktuar. Kështu, përmendim: Besova në Zot, xhami, Kuran, hoxhë, opinion, bashkëkohësi, islam, përpjekje, hap pas hapi, udhë, përhapni për mua qoftë dhe një fjalë, kujtime, refleksione, Ramazan, hatib, hënë e Ramazanit, Nún Pasha Lapsin, Dëshmitar në Sahar, Lutje, etj., etj.

Zidni!.. Ashtu siç na thotë autori Muhamed B. Sytari, libri “Zidni” është një përmbledhje me studime, ese, intervista, mesazhe... (dhe më pas ka vënë një reticencë); dhe periudha e punimeve është: korrik 2013 – dhjetor 2014. Libri ka një koncept, një filozofi e një ndërtim kompozicional e strukturor. Përbëhet sipas kësaj skeme: - parathënie e më pas vijnë radhazi pesë vatra tematike, të cilat respektivisht janë: *Studime *Ese *Intervista *Mesazhe dhe Derse *Thirrje Shpirti.

(Këtu do të bëj një parantezë. Libri “Nún Pasha Lapsin...” botuar në vitin 2013 ka pothuajse të njëjtin portret kompozicional si “Zidni”, natyrisht ky i fundit vjen më i plotë dhe më i pasuruar me probleme dhe dukuri të kohës. Kështu që, mendoj se janë vazhdim i njëri-tjetrit dhe duhen lexuar në “En bllok” (En bloc-njëherësh). Kështu gjejmë edhe gjurmë të përbashkëta, duke ruajtur njëkohësisht veçoritë e tyre. Kështu, për shembull: Koha është një shenjë që “lëviz” në të dy librat. Ajo paraqitet: *e afët, *e largët, *e pranishme, *e nënkuptuar, *me fat dhe pa fat, *si dhimbje, si plagë, *si dëshirë e si dëshmi, *si ndrydhje e si ëndërr, *si humbëtirë e si fatlume, *si errësirë e si dritë, *si shpresë e si ekzistencë, etj. Përveç analizës së nocionit Kohë, librat kanë dhe dy shenja të tjera, kësaj here në kujtesë, ku pasurohet biografia e tyre librorë. “Nún Pasha Lapsin...” u botua në prill të vitit 2013, me rastin e tre vjetorit të drejtimit të Myftinisë Shkodër nga ana e autorit. “Zidni” po promovohet si botim i ri, me rastin e 25-vjetorit të rilejimit të fesë me ligj, dhe të rihapjes së Xhamisë së Plumbit. Ritheksojmë edhe njëherë, ndonëse librat duhen lexuar “En bllok” (En bloc-njëherësh), ata ruajnë në vetvete etapa dhe kontekste të ndryshme realitetesh shoqërore.

1. KAPITULLI I PARË I EMËRTUAR “STUDIME”

Kapitulli që mbart peshën kryesore të librit. Autori paraqet shumë këndvështrime, shumë pika takimi në rrafshet kohore e vendore. Si i tillë na prezantohet si një studiues i zellshëm, këmbëngulës, gjurmëlënës e i përkorë. Komunikon me modele vlerash të krijuara gjatë shekujve, dekadave dhe viteve. I dritëson. Dua të shkoj më tej. Është libër i personazheve-modelë – hoxhallarë të shquar e mendjendritur shkodoranë e më gjerë. Këto modele – përfaqësimi, modele si modele të çdo kohe. Janë teste. Ti i nderuar lexues nuk po shfleton faqet e librit “Zidni”, por faqet e një testamenti që nuk duhet lënë në harresë. Dhe kështu “takohesh” me Haxhi Jusuf Këlmendin, Haxhi Sulejman Gavoçin, që autori e quan ‘Hoxha i jonë’, Hafiz Halid Bushatin, Isuf efendi Tabakun, Hafiz Ibrahim Repishtin, etj. Pra, personazhe që të falin mençuri, urtësi e dritë. Ndaj, dhe ky libër është i dritësuar! Kështu siç janë vizatuar e gdhendur, përfaqësojnë shkolla diturie. Të tillë shpalosen në libër – Ulematë e Shkodrës tonë! Dhe këto arritje vlerash bëhen të mundur falë dimensionit kulturologjik të autorit, që është për t’u patur zili.

Në përfundim, po përcjell këtë mesazh, duke cituar fragmentin e shkkrimit: “Përkushtimi i sahabëve ndaj Resulullahut – model frymëzues për myslimanët”.

‘Përse duhet të kthejmë sytë nga sahabët dhe modeli i përkushtimit të tyre në raport me besimin, fenë, Resull-llahun (a.s.), Kur’anin, jetën? Sepse ata ishin modeli më i saktë, më i përsosur, më i kompletuar, sikurse edhe në Kur’an thuhet për ta: “Populli më i mirë i dalë për njerëzimin”. (Kur’ani, Ali Imran, 110) (f.22, “Zidni”)

2. KAPITULLI I DYTË I EMËRTUAR “ESE” (NDALESË E SHKRIMIT: “KOHA PËR TË MOS U BËRË PALË ME HESHTJEN...)

U ndala te kjo ese për shumëçka e për shumë arsye. Por më themeloria: në mënyrë konkrete e reale, pa doreza; shpalosen pikëpamjet, filozofia, konceptet e ardhmërisë të punës e të platformës së institucionit të Myftinisë, të cilat kanë një lidhje të pazgjidhshme me cilësitë e vyera dhe karakterin qëndrestar të autorit duke qenë besëtar

i palëkundur i shkollës së Thirrjes Islame.

Në esenë argumentuese trajtohen një dendësi problemesh, disa janë imperative, të tjera madhore. Toni është i papajtueshëm me regresiven, me penguesit, me zemërkëqinjtë. Kjo duket qartë në ndërtimin e frazës dhe në artikullimin e saj. Është përceptuar argumentuese dhe sprovë komunitare. Për t’i dhënë gjerësi e dimension problemeve. Kam vënë shenjën te një frazë, e cila thotë: “A ka fajtor... (ri) grabitjes së pronave të shenjta vakëf, nëpërmjet ligjit të legalizimit, moskompensimit serioz të pronave vakëf, të sekuestruara e të tjetërsuara nga shteti komunist?” E lexoja disa herë këtë frazë, sikur ajo të më kujtonte Gerald Frost-in, njërin nga këshilltarët e Margaret Thatcher, gruas që qeverisi për 12 vjet Britaninë duke e ndryshuar atë dhe botën. Në një intervistë Frost thotë: “Shqipëria do të ketë një të ardhme shumë më të ndritshme, nëse... mund t’u sigurohet të gjithëve e drejta e pronës...”. Më tej vazhdon... “Hapi i parë dhe më i rëndësishmi që duhet të bëni është të siguronit të drejtën e pronës, duke qenë se mungesa e saj ka qenë faktor madhor që ka riskuar zhvillimin ekonomik në shumë vende në zhvillim”.

3. KAPITULLI I PESTË I EMËRTUAR “THIRRJE SHPIRTI...”

Gjatë leximit të kapitullit të fundit të tekstit është pamundur të mos shijosh “parfumin” apo “aromën” e rrëfimit lirik të autorit, këtë tubëzë prozash poetike, që kanë një kurorë me emrin “Thirrje Shpirti...” Flet shpirti i shpirtëzuar i autorit. Në heshtje, në komunikime, në rrëfime magjike e të magjishme, të një bote ku dhe ëndrrat flasin... Janë një tubëzë prozash poetike të thurura plot frymëzim. Plot dashni shpirti e zemre!

Duke marrë shkas nga këto meditime, kuptoj që personalitetit të autorit iu shtua edhe një tipar, një ndjesi poetike, ajo e poetit. Nuk ka mbyllje më të bukur libri se këto proza erëpoetike! Është dhe një risi për librin, për bibliotekën e kësaj tipologjie. Ka një të vërtetë, këto proza poetike mungojnë në natyrën e këtyre librave në gjuhën shqipe. Mbase këto janë të parat... Kjo pranverë e ardhur, le të shtohet dhe me lule të tjera!

Ndërthurja harmonishme teologjiko-art përbën një tharm të mrekullueshëm në faqet e këtij libri. Ky tharm shenjon

një vijëzim më tepër në portretin e autorit, e plotëson, e dimensionon dhe e kristalizon individualitetin e tij. Kushdo do të emocionohet sapo t’i lexonte këto fjalë-kyçe, fjalë-kyçe që u ngjajnë bukurezave që ndrisin në netët e majit, ku njëra nga këto net-bukurezash përkon në ditëlindjen e autorit. Ja, disa fjalë-xixëllonja që na japin isharet dhe njohje gjatë leximit të tubëzës poetike, si: shiu, mall, lot, Damask, zemër, kujtime, qetësi, natë, gjurmë, erë myshku, nur, Qabe, ihram, yje, qiell, sy, Mevlana, tavaf, thirrje, vështrim, mësues, dritë, heshtje, mirësi, Shkodër, etj.

I nderuar lexues, i lexon dhe i rilexon këto fjalë të shenjta që autori “i shenjëtëron” në krijimet e tij poetike, dhe si një fllad i ëmbël e ledhatar, si pakuptuar hyjnë dhe “pushojnë” dhe në shpirtin tënd. Ta ndrit shpirtin ky këngëzim i autorit, ky komunikim i tij herë tokësor e herë hyjnor, herë magjik e herë mistik, me plot detaje poetike e figura letrare. Autori nuk bën gjë tjetër veçse bekon prozën e tij poetike përmes shpirtit të tij.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Shpesh herë, si gjatë leximit dhe rileximit të tekstit në dorëshkrim, më pas të tekstit si libër, gjithnjë kam menduar dhe pyetur veten: Pse ka kaq dritë mirësie libri “Zidni” i autorit Muhamed Bardhyl Sytari? Duke shfletuar librin me kujdes e vëmendje, mendoj, se e kam gjetur përgjigjen (f.250) te një fragment, që ato rreshta herë më ngjajnë si Pleq të mençur e proverbialë, herë si çallma të bardha të një bote të bardhë e fisnike, herë si një Udhërrëfim, Udhërrëfyes, Kujtesë, Mos-harrim, Aktbesim, Aktdritësie, Akt...

“Ej natë e madhe loti, që zemrën zgjon nga dehja e ditëve pa dritë e mall kujtimesh, drejt mirësive të ofshamave të mekura nga thellësitë e qënies, me kokën në duart e buta të Mësuesit, bekuar qofsh! Merre lotin tim dhe ktheje në notë malli, si një tingull që në tavafe drite bashkohet me thirrjen: Ja All-llah..! E, përulësisht, tingujt e kësaj dashnie, si një fllad misk Mësuesi, lësho mbi botë, që paqja dhe drita, errësitat të mbulojnë...”

Shkodër, 12. 11. 2015

E XHUMAJA E NJË DITE, SA 25 VITE DËSHMI...

Me mijëra besimtarë muslimanë të Shkodrës, morën pjesë sot, më 13 nëntor 2015, në faljen masive të namazit të xhumasë, në sheshin bri xhamisë së Plumbit, në përkujtim të ceremonisë së papërsëritshme të rihapjes masive të xhamisë së Plumbit, më 16. 11. 1990.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin besimtarë të shumtë nga të gjitha xhematet e qytetit, por edhe nga fshati, që kishin ardhur për të marrë pjesë në këtë falje të veçantë, në një atmosferë të mrekullueshme besimi dhe harmonie islame.

Rreth orës 11.45, në shesh kanë mbërritur drejtues të lartë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, nën drejtimin e nën/kryetarit, H. Bujar Spahiu, që shoqërohej edhe nga H. Islam Hoxha, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të KMSH, njëherazi dhe Myfti i Kukësit, Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër, H. Agim Duka, Myfti i Elbasanit, H. Edmir Smajlaj, Myfti i Malësisë së Madhe, H. Eduart Demiraj, Myfti i Tropojës, H. Agim Terziu, Myfti i Lezhës, H. Gëzim Kopani, Myfti i Pukës, si dhe imamët e qytetit të Shkodrës.

Pas këndimit të ezanit, nga z. Ervin Metani dhe faljes së katër rekateve para xhumasë, hytbeja e kësaj xhumaje u mbajt nga Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari.

Në mesazhin e tij të kësaj xhumaje madhështore, Myftiu vlerësoi me mirënjohje dhe respekt të gjithë ata të rinj e burra të urtë shkodranë, që 25 vite më parë, morën pjesë në lëvizjen



e madhe për rihapjen e xhamisë së Plumbit, e vetmja që kishte ngelur në këmbë, pas 23 vitesh persekutimi dhe dhune ndaj besimit dhe fesë në Shqipëri.

Myftiu përmendi shembullin e Hafiz Sabri Koçit, si një njeri i sprovuar në fenë e tij dhe një muxhahid sakrifkues në burgjet e femohimit.

Në mesazhet e kësaj hytbeje, Myftiu ftoi të pranishmit ta jetojnë Islamin në jetën e përditshme, ta nxjerrin atë nga xhamia dhe të ndjehen krenarë për këtë mirësi të madhe të udhëzimit në Islam.

“Sot, në këtë atmosferë të lirë të besimit, në këtë përvjetor jubilar të 25-të të rihapjes së xhamive dhe medreseve tona, e kemi për detyrë ta dëshmojmë veten si thirrës të sinqertë e të vendosur drejt përhapjes së mësimave të Kur’anit

dhe traditave të Hz. Muhammedit (a.s).

Sidomos, ato që lidhen me harmoninë kombëtare, me jomuslimanët, me respektimin e ligjit dhe me distancimin nga dhuna, terrori, ekstremizmi dhe çdo shfaqje joislame, që e njollos fenë dhe bashkësinë tonë të qytetëruar islame! Sepse ekstremizmi dhe terrori nuk kanë fé, ato janë sëmundje që përhapen kudo, ndërkohë që ne, jemi të vendosur në rrugën e paqes, dialogut, harmonisë dhe bashkëpunimit me këdo që bashkohet me ne në këtë njet të lashtë të besimit dhe përhapjes së vlerave të tij në shoqëritë njerëzore!” - tha ndër të tjera Imam Muhamed B. Sytari.

E xhumaja e sotme u dëshmuua si një ditë e lumtur besimi dhe rikujtimi i një ngjarjeje të madhe në historinë tonë kombëtare.

Të pranishëm në faljen e kësaj xhumaje të mbushur me emocione dhe gëzim, ishin edhe drejtuesit më të lartë të pushtetit vendor e atij lokal: znj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër, znj. Greta Bardeli, Kryetare e Qarkut Shkodër, z. Maxhid Cungu, nën/kryetar i Këshillit të Qarkut Shkodër, antarët e Kryesisë së KMSH: z. Genti Kruja, z. Astrit Zharri dhe z. Dorian Demetja, si dhe drejtues të lartë të shoqatave islame në vendin tonë: z. Tahir Zeneli, Kryetar i Shoqatës “Ardhmëria”, z. Korab Kaja, Kryetar i Fondacionit “Mirësia”, z. Sokol Mandi, Drejtor i Shoqatës “Burimi”, z. Ridvan Seferaj, Kryetar i Shoqatës “Istanbul”, z. Kujtim Dervishi, Drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër etj.



KONFERENCA: “25 VJET LIRI BESIMI – SFIDA, SPROVA, PERSPEKTIVA”

Paraditën e së shtunës, më 14 nëntor 2015, Myftinia Shkodër organizoi konferencën shkencore me temë: “25 vjet liri besimi – sfida, sprova, perspektiva”.

Fillimisht konferenca u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili vuri theksin te nevoja e leximit të duhur të përballjes së muslimanëve me realitetet në këto 25 vite, si dhe te e ardhmja e Islamit në Evropë e botë, ku ripërsëriti se ky shekull është i Islamit dhe përhapjes së vlerave të tij, sidomos në perëndim.

Konferenca u përshëndet edhe nga znj. Voltana Ademi, e cila falënderoi Myftininë Shkodër për organizimin e kësaj konference, si dhe organizimin e ditës së djeshme në xhaminë e Plumbit.

Konferenca vijoi sipas programit:

Dr. Genti Kruja (drejtor i kulturës dhe dialogut ndërfetar, KMSH) - “Dialogu ndërfetar, sfidë dhe realitet”

Msc. Anduena Qefalia (pedagoge, I.T.C, Tiranë) - “Modeli i ekonomisë së tregut vs. ekonomisë së centralizuar dhe paradigma



islame”

Artur Tagani (Phd Candidate, U.E.T)

“Imazhi i besimtarit shqiptar mes “njeriut të ri” komunist dhe “shqiptarit evropian” të humbur”

Lavdrim Hamja (imam, Myftinia Shkodër) - “Çerek shekulli liri besimi - refleksione dhe perspektiva”

Nga referatet e mësipërme, u dhanë mesazhe të rëndësishme, ku vlen të përmendet:

1. Vlera e harmonisë ndërfetare e bazuar në tekste të sakta fetare, në

shërbim të harmonisë kombëtare dhe paqes sociale.

2. Krahasime në mes ekonomisë perëndimore dhe asaj socialiste lindore, në krahasim me bazat e ekonomisë islame.

3. Krahasime të edukimit të orientuar në periudhën komuniste, me atë pas viteve '90 në vendin tonë dhe anashkalimi i vlerës islame në edukim në tekstet e sotme shkollore.

4. Problematikat e rimëkëmbjes islame në 25 vitet e fundit në Islam, sprovat, sfidat, zgjidhjet.

MESAZHE HARMONIE DHE PAQEJE NË 25 VJETORIN E RIHAPJES SË XHAMISË SË PLUMBIT

Paraditën e së hënës, më 16 nëntor 2015, në ditën e 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, Myftinia Shkodër organizoi ceremoninë simbolike të inaugurimit të pllakatës përkujtimore pranë shtëpisë së familjes Myftija, në lagjen Tabakë.

Shtëpia në fjalë, shërbeu si qendër kryesore e takimeve të para dhe mbledhjeve kryesore në ditët e rëndësishme të nëntorit 1990, ku me datën 16 të atij muaj, u organizua edhe ceremonia madhështore e fjalimit historik të H. Sabri Koçit.

Në praninë e mediave, intelektualëve, besimtarëve dhe familjarëve të familjes Myftija, pllakata përkujtimore u zbulua nga Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari dhe Famullitari i Kishës Ortodokse Shkodër, At Nikolla Petani.

Në një mesazh për mediat e pranishme, Myftiu theksoi se kjo datë është shumë e rëndësishme për Shkodrën dhe muslimanët e saj, sikurse theksoi se mesazhet që përcjell kjo ditë e shënuar e përkujtimit të rihapjes së xhamisë së parë pas 23 vitesh persekutim, janë mesazhet e harmonisë dhe jetës dhe distancimit nga fryma e urrejtjes, dhunës e terrorit, që



është i dënuar në çdo besim e fe.

Një mesazh urimi dha edhe At Nikolla Petani, që uroi besimtarët muslimanë për këtë datë të rëndësishme, si dhe uroi që fryma e bashkëpunimit dhe harmonisë në mesin e besimtarëve të jetë e përhershme në Shkodër e mbarë Shqipërinë.

Edhe H. Mithat Myftija, imam i xhamisë së Plumbit, falënderoi Myftininë e Shkodrës për këtë ceremoni dhe mesazhet e saj dhe theksoi se kujtimi i atyre ditëve të vështira të nëntorit 1990 do të ngelet i pashlyer në memorien e familjes së tij dhe qytetarëve shkodranë.

Më pas, u fal namazi i mesditës në xhaminë e Plumbit, ku ezani i kohës u

këndua, nga H. Vehbi Dani, si para 25 vitesh.

Në përfundim, u zhvillua një bashkëbisedim i ngrohtë, ku dhanë mesazhet dhe emocionet e tyre, Imam Muhamed B. Sytari, Dr. Genti Kruja, drejtori i kulturës në KMSH dhe H. Vehbi Dani, që përcolli emocionin e madh të këndimit të ezanit pas 25 vitesh në xhaminë e Plumbit, si atë ditë të bekuar, i caktuar nga H. Sabri Koçi.

Pas këndimeve kur'anore, imami i nderuar Lavdrim Hamja bëri një dua për besimtarët e parë, që rihapën xhaminë e Plumbit dhe të pranishmit.

SHFAQET DOKUMENTARI: “TRIUMFI I ZANIT TË MINAREVE”

Mbrëmjen e së hënës, më 16 nëntorit 2015, Myftinia Shkodër organizoi në teatrin “Migjeni”, aktivitetin përmbyllës të programit 17 ditor kushtuar përkujtimit të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë në Shkodër e Shqipëri, pas 23 vitesh persekutim e dhunë ateiste ndaj fesë.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm autoritetet më të larta fetare e civile të vendit, si: H. Skender Bruçaj, Kryetar i KMSH, z. Ilir Dizdari, Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kultet, Lutfi ef Ballek, Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Mons. Angelo Massafra, Arqipeshkëv Shkodër-Pult, znj. Greta Bardeli, Kryetare e Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Xhemal Bushati, Kryetar i Këshillit të Bashkisë Shkodër, H. Edmir Smajlaj, Myfti i Malësisë së Madhe, z. Kujtim Dervishi, drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, deputetë, drejtues të partive politike, imamë të xhamaive, kryetarë të shoqatave islame në vendin tonë etj.

Fillimisht, të pranishmit ndoqën me vëmendje premierën e dokumentarit me titull: “Triumfi i zanit të minareve”, ku u shfaqen dëshmi dhe fakte nga koha e vështirë e vitit 1967 e më pas, kur besimtarët muslimanë, por jo vetëm, u përballën me diktaturën komuniste dhe me ndalimin e fesë ligjrisht.

Njëherazi, u shfaqën edhe momentet kryesore të dëshmisë historike të ceremonisë madhështore të datës 16 nëntor 1990 dhe fjalimit historik të mbajtur nga Hafiz Sabri Koçi dhe dëshmi të pjesëmarrësve aktivë të atyre ditëve



të rëndësishme.

Aktiviteti vijoi me fjalën e rastit, mbajtur nga H. Skender Bruçaj, Kryetar i KMSH, i cili vlerësoi datën 16 nëntor 1990, si një moment kthese në historinë tonë kombëtare.

Kryetari i KMSH vlerësoi se liria e besimit është esenciale për jetën e njeriut, sikurse theksoi se besimi është i barazvlefshëm me krejt vërtetët dhe bindesh me krejt tentativat për të mbjellë terror dhe urrejtje në botë.

Kryetari i KMSH dënoi ashpër zhvillimet e fundit në shumë vende të botës, ku po shfaqen akte terroriste, vrasje të njerëzve të pafajshme dhe nxitje të urrejtjes, si akte të papranueshme nga feja islame dhe ndërgjegjja islame.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga znj. Greta Bardeli, e cila vlerësoi lirinë e besimit si bekim nga Zoti dhe mirësi për popujt. Ajo vlerësoi shpirtin e harmonisë

ndërfetare si një begati për popullin shqiptar dhe historinë e tij.

Në emër të institucionit që drejton, znj. Bardeli i akordoi Myftiut të Shkodrës, certifikatë për dhënien e titullit: “Nderi i Qarkut Shkodër”, Myftinisë Shkodër.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër, i cili vlerësoi këtë datë dhe dha mesazhet e tij kushtuar lirisë së besimit, harmonisë kombëtare e fetare dhe respektimit të jetës dhe lirisë individuale në shoqëri.

Myftiu ftoi të pranishmit të ngrihen në këmbë dhe të këndojnë një “Fatiha” për ata qindra mijëra të pafajshëm që janë vlarë anëmbanë botës në vitet e fundit, si pasojë e terrorizmit.

Një program i bukur artistik, me pjesë të përzgjedhura, ilahi e recitime, nga nxënësit e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër, i dha emocione të bukura këtij tubimi përmbyllës.

Mbrëmjen e së hënës, më 16 nëntor 2015, gjatë aktivitetit të shfaqjes së premierës së dokumentarit “Triumfi i zanit të minareve” dhe aktivitetit kushtuar 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, Myftinia Shkodër është nderuar me titullin: “Nderi i Qarkut Shkodër”, nga institucioni i Këshillit të Qarkut Shkodër.

Ka qenë znj. Greta Bardeli, Kryetare e K.Q. Shkodër, ajo që i ka akorduar Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, këtë certifikatë vlerësuese të punës dhe kontributit 25 vjeçar të Myftinisë Shkodër.

Në motivacionin e këtij titulli nderi, shënohet: “Për veprimtarinë e çmuar shoqërore e humane në dobi të

MYFTINIA SHKODËR, “NDERI I QARKUT SHKODËR”



banorëve të Qarkut, për ruatjen dhe rritjen e vlerave shpirtërore si dhe për kontributet e shquara në forcimin e harmonisë dhe paqes në Qarkun Shkodër”.

Pas marrjes së titullit nderues, Myftiu falënderoi znj. Bardeli për këtë vlerësim publik që i bëhet Myftinisë Shkodër, duke theksuar se ky titull i takon të gjithë atyre që kanë punuar dhe janë lodhur maksimalisht për të mirën e komunitetit, për përhapjen e mesazheve të paqes dhe harmonisë, si dhe me ndihmat e ndryshme të njerëzve në nevojë.

13 NËNTOR 2015 - E XHUMAJA E NJË DITE, SA 25 VITE DËSHMI...



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org